



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 273/4 Prot.

Tiranë, më . 22.2 .2019

V E N D I M

Nr. 88 datë 22.02.2019

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 22.02.2019, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Znj. Gentiana Sula	Kryetare
Z. Altin Hoxha	Anëtar
Z. Simon Mirakaj	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i “Rregullores mbi publikimet e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, Ligji nr. 119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, Ligji Nr.9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar

Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi draft-*Rregulloren mbi publikimet e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj*:

V Ë R E N:

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si Institucion, i pavarur, është përgjegjës për zbatimin e ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Autoriteti i kryen funksionet e tij, të përcaktuara në këtë ligj, në mënyrë kolegjiale.

Sipas nenit 7 të ligjit Autoriteti ka pavarësi të plotë në vendimmarrje për ushtrimin e funksioneve të veta, që burojnë nga ky ligj apo aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në pikën 3, të nenit 7 parashikohet shprehimisht se Autoriteti organizohet dhe funksionon sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në rregulloren e funksionimit, që miratohet prej tij.

Sa më sipër, dhe në funksion të detyrave që ligji nr.45/2015, si dhe të i ka ngarkuar Autoritetit, si dhe të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, si dhe të Ligjit nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, është hartuar draft – “Rregullorja mbi

publikimet e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”, me të cilin janë njohur paraprakisht anëtarët e Autoritetit.

Drafti i “Rregullores mbi publikimet e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”, duke u bazuar dhe në urdhërat, udhëzimet dhe vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është konsultuar dhe ka marrë miratimin e këtij të fundit, për temën objekt vendimi.

Për sa më sipër, si dhe në zbatim të ligjit nr. 45/2015, Autoriteti vlerëson të miratojë “Rregulloren mbi publikimet e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, në Ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, Ligjin nr. 9887/2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores mbi publikimet e veprimtarisë së Autoritetit në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARJA

Gentiana Sula



ANËTAR

Altin Hoxha

ANËTAR

Simon Mirakaj